



**Regional Project on
Social Rights for
Vulnerable Groups
(SoRi)**



**RAPORTI I VLERËSIMIT MBI SITUATËN
AKTUALE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE
TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË
NIVEL KOMBËTAR DHE LOKAL**

Mars 2019

Raporti i vlerësimit është përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të iniciativës me temë “Monitorimi dhe promovimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale për grupet vulnerabël në nivel kombëtar dhe lokal (Kukës, Elbasan dhe Librazhd)”, me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Opinionet e shprehura në këtë material nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	2
I. Sfidat dhe çështjet strukturore.....	3
II. Kuadri ligjor dhe institucional	4
III. Raporti Kombëtar Vullnetar	6
IV. Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit në ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm	7
V. Qeverisja lokale dhe zbatimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm	9
V.1 Rritja e ndërgjegjësimit	10
V.2. Advokimi/ përfshirë perspektivën në nivel lokal të strategjive kombëtare që lidhen me OZHQ.....	11
V.3 Zbatimi/ OZHQ-të në nivel lokal.....	12
V.4. Monitorimi	13
VI. Situata aktuale për arritjen e OZHQ-ve në nivel vendor	14

Hyrje

Në shtator të vitit 2015 u zhvillua takimi i Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), ku Qeveria e Shqipërisë, së bashku me 192 vendet anëtare të OKB-së, u angazhuan për zbatimin e Axhendës 2015-2030 për zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet miratimit të deklaratës së përbashkët.

Axhenda për zhvillimin e qëndrueshëm është shumë komplekse. Ajo përbëhet nga **17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe 169 synime (targets)**, objektiva të veçanta (targete), duke mbuluar të gjitha dimensionet kryesore të zhvillimit:

- i. Dimensioi ekonomik,
- ii. Dimensioi social ;
- iii. Dimensioi i mjedisit

Ndonëse kjo axhendë duhet të përqafohet dhe zhvillohet në nivel global, ajo është projektuar për të mbuluar prioritetet dhe veçantitë e çdo vendi. Në këtë kontekst, axhenda duhet të përshtatet me kontekstin specifik të vendit, në mënyrë që objektivat dhe synimet të jenë të kuptueshme, të realizueshme dhe me ndikim në nivel vendi. Për këtë qëllim, është i rëndësishëm përcaktimi i nivelit të korrelacionit ndërmjet Axhendës 2030 dhe prioriteteve të politikave të brendshme të çdo vendi.

Në nivel global, në kuadër të zbatimit të Axhendës 2030, në mars të vitit 2016 është miratuar dhe dakordësuar korniza e treguesve globalë (lista me 230 indikatorë), e cila është zhvilluar nga grupi i ekspertëve për treguesit e OZHQ (IAEG-SDG). Këta tregues, së bashku me treguesit në nivel rajonal e kombëtar (që do të zhvillohen nga vendet respektive) do të shërbejnë, në vijimësi, për monitorimin e OZHQ-ve.

Zbatimi i Axhendës 2030 nën sloganin “të mos lëmë askënd pas” kërkon gjithëpërfshirjen dhe partneritetin e aktorëve të rëndësishëm në nivel global, rajonal, kombëtar dhe lokal, duke përfshirë në radhë të parë grupet në nevojë/të lëna pas - gratë dhe vajzat, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, etj – parlamentin, autoritetet qendrore dhe lokale, sektorin privat, institucionet akademike, organizata të shoqërisë civile e më gjerë.

I. Sfidat dhe çështjet strukturore

Shumë njerëz sot janë të mënjanuar, sidomos ata më të varfërit dhe ata në pozitë të pafavorshme për shkak të gjinisë, moshës, paaftësisë, përkatësisë etnike apo vendndodhjes gjeografike. Ende sot, ekzistojnë boshllëqe të mëdha midis familjeve që jetojnë në zonat rurale dhe urbane, si dhe shumë familje që jetojnë në varfëri absolute dhe ekstreme, duke u privuar nga ofrimi dhe aksesimi në shërbimet bazike.

Shqipëria tashmë ka përqafuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe e gjithë puna e përbashkët institucionale midis shumë aktorëve si: Parlamenti, Njësitë e Qeverisjes Vendore; bizneset; shoqëria civile, etj, duhet të bazohet në objektivat me një fokus kryesor në zhdukjen e varfërisë, pabarazisë dhe realizimit të dinjitetit njerëzor.

Sipas treguesve të nxjerrë nga INSTAT rreth 14.3% e popullsisë në vendin tonë jetojnë në varfëri absolute me konsum mujor real nën 4891 lekë, ndërkohë që rreth 2.2% e popullsisë jetojnë në varfëri ekstreme, kur ende nuk ka një minimum jetik të deklaruar në Shqipëri si koncept që lidhet ngushtë me nevojat që ka individit për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, si dhe me përcaktimin dhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes sociale, sigurimeve shoqërore, sistemit të pagave, etj.

Të 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasqyrojnë një proces gjithëpërfshirës, me qeveritë që duhet të bashkëpunojnë me të gjithë sektorët e shoqërisë dhe një shumëllojshmëri të gjerë aktorësh, duke përfshirë akademinë, biznesin, shoqërinë civile dhe publikun. Axhenda 2030 bën thirrje për veprim për të siguruar që të gjithë janë të përfshirë dhe gjithashtu të vënë në qendër të vëmendjes, sidomos ata që kanë më shumë nevojë për veprim. Ky parim duhet të reflektohet gjerësisht në të gjitha dimensionet kryesore të politikës sociale në Shqipëri, për të mbrojtur qytetarët nga rreziqet e goditjeve të jetesës përmes kontributit më të rëndësishëm në fushat e përfshirjes sociale dhe fuqizimit të gruas.

Arritja e OZHQ -ve në Shqipëri do të kërkonte angazhim dhe bashkëpunim të konsiderueshëm të të gjithë aktorëve relevantë në vend. Ndërsa disa OZHQ përfshijnë objektiva të matshme dhe specifike që do të arrihen deri në vitin 2030, shumica e objektivave të tjerë ofrojnë udhëzime për politikën dhe qëllimet/objektivat e lidhura mbeten në kontekstin kombëtar. Prandaj është shumë e rëndësishme të fillohet një proces nga poshtë-lart për të krijuar vizionin kombëtar për vitin 2030, veçanërisht në fushat më të rëndësishme të politikave për Shqipërinë. Ky proces duhet të bazohet në kontributin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve të përfshirë dhe duhet të sigurojë një konsensus të gjerë politik.

Për të arritur suksesin në zbatimin e Axhendës 2030 dhe arritjen e vizionit kombëtar për vitin 2030, Shqipëria do të duhet të angazhohet në procesin e krijimit të një udhërrëfyese (*roadmap*) për procesin e zbatimit të OZHQ-ve, i cili do të ndihmonte në identifikimin e roleve dhe përgjegjësisë të institucioneve kryesore dhe aktorë të tjerë në proces.

Përgjegjësia e vendosjes së prioriteteve në Axhendën 2030 do të ishte një proces i gjatë, i informuar, i balancuar dhe transformues, që kërkon përpjekje shtesë nga institucionet shqiptare dhe partnerët e zhvillimit. Zbatimi i OZHQ-ve kërkon përmirësimin e kapaciteteve institucionale, jo vetëm në nivel të ministrive të qeverisë qendrore, por edhe për qeverisjen lokale, akademinë, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces.

Në veçanti, procesi i zbatimit të OZHQ-ve do të kërkonte burime dhe mekanizma adekuate për përdorimin e të dhënave dhe të indikatorëve kombëtarë për qëllime monitorimi. Forcimi i kapaciteteve statistikore në nivel kombëtar konsiderohet një sfidë e rëndësishme në proces.

II. Kuadri ligjor dhe institucional

Shqipëria ka përqafuar Partneritetin Global, i projektuar për të dhënë një kontribut të fuqishëm në arritjen e Axhendës 2030 dhe është plotësisht e angazhuar për zbatimin e Axhendës 2030 në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe procesin e Integritimit Evropian. Në kuadër të arritjeve të këtyre objektivave Qeveria Shqiptare ka ngritur strukturat përkatëse në nivel qendror, duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë që ato kanë në procesin e zbatimit të OZHQ-ve.

Koordinimi dhe udhëheqja e procesit sigurohet nga Komiteti Ndërmintor për OZHQ-të, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri i Shqipërisë dhe që përbëhet nga institucionet kryesore qeveritare si dhe aktorë të tjerë nga komuniteti i biznesit, shoqëria civile, akademja dhe organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë mbështetjen teknike të Departamentit të Zhvillimit dhe Qeverisjes së Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe kontributin e agjencive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Deri më sot, në aspektin ligjor, në lidhje me këtë proces janë miratuar:

- Urdhëri i Kryeministrit Nr.63, datë 12.5.2017 “Për ngritjen e Komitetit Ndërmintor për arritjen e OZHQ-ve, si dhe zbatimin e axhendës 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm”, ndryshuar me Urdhërin 249, datë 28.12.2017;
- Urdhëri i Kryeministrit nr.70, datë 22.5.2017 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe masat zbatuese për axhendën 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm”, ndryshuar me Urdhërin Nr.248, datë 28.12.2018.

Edhe Kuvendi i Shqipërisë ka konfirmuar vullnetin dhe angazhimin ndaj Axhendës 2030, nëpërmjet miratimit unanim, më datë 04.12.2018, të Rezolutës “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Axhendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”, që konfirmon angazhimin e Shqipërisë ndaj Axhendës 2030, pasi ajo luan një rol të rëndësishëm në monitorimin e arritjes së Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në këtë rezolutë theksohet, ndërmjet të tjerash, angazhimi i Kuvendit të Shqipërisë për të “*ofruar mbështetje për institucionet qeverisëse në nivel vendor për të zbatuar dhe monitoruar Objektivat e Zhvillimit të*

Qëndrueshëm, duke pranuar se ato janë më afër me qytetarët dhe shpesh kanë përgjegjësi për çështje të rëndësishme në arritjen e OZHQ-ve”.

Si pjesë e angazhimit të të gjitha palëve të interesuara në proces, më 24 tetor 2017, në ditën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 25 universitete publike dhe private në Shqipëri nënshkruan një marrëveshje për të luajtur një rol aktiv në avancimin e Axfordës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Shoqëria civile dhe organizatat e sektorit privat do të duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në këtë proces duke integruar OZHQ-të në modelet e biznesit dhe aktivitetet që ato kryejnë në Shqipëri.

Bazuar në urdhërat e mësipërm, janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e mëposhtme:

Komiteti Ndërministror për OZHQ-të, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë:

- ✓ Sigurimi i dialogut qeveritar me palët e interesuara për masat, në kuadër të arritjes së OZHQ-ve;
- ✓ Përgatitja për miratimin e Udhërrëfyesit për arritjen e OZHQ-ve në Këshillin e Ministrave, si dhe raporti për ecurinë e saj;
- ✓ Raportimi për arritjen e OZHQ-ve në Komitetin e Planifikimit Strategjik;
- ✓ Sigurimi i përthyerjes së OZHQ-ve në kuadrin strategjik të vendit;
- ✓ Formulimi i rekomandimeve mbi masat legjislative, politikat e nivelit të lartë dhe orientimi institucional, si dhe programet kombëtare në mbështetje të arritjeve të OZHQ-ve;
- ✓ Promovimi i financimit të zbatimit të OZHQ-ve përmes procesit të PBA-së dhe në bashkëpunim me DIP-të, përmes SPI-së.

Grupi Ndërinstitucional i Punës, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë:

- ✓ Përgatitja e udhërrëfyesit për arritjen e OZHQ-ve;
- ✓ Identifikimi / zhvillimi i instrumenteve / mjeteve, propozimi dhe zbatimi i masave për të arritur SDG brenda afatit kohor të udhërrëfyesit;
- ✓ Koordinimi zhvillimin/ zbatimin e planeve/ politikave/ masave sektoriale për arritjen e OZHQ-ve;
- ✓ Bashkërendimi i objektivave dhe treguesve me kuadrin strategjik të vendit, SKZHI dhe strategjitë sektoriale, përmes përgatitjes së “Raportit mbi përthyerjen e OZHQ në politikat sektoriale ekzistuese”;
- ✓ Raporti në Kabinetin e Kryeministrit, në mënyrë periodike, për përmbushjen e përgjegjësisë.

Komiteti Ndërministror për OZHQ-të mbështetet nga aktiviteti i Grupit Ndërinstitucional të punës për OZHQ-të, i cili përfshin përfaqësues të nivelit teknik nga të gjitha institucionet shqiptare që marrin pjesë në zbatimin e Axfordës 2030. Grupi ndërinstitucional i punës për OZHQ-të është takuar gjashtë herë gjatë vitit 2018 për të diskutuar dhe kontribuar në procesin e

arritjes së OZHQ-ve. Departamenti për Zhvillim dhe Qeverisje të Mirë në zyrën e Kryeministrit vepron si sekretariat teknik në Komitetin Ndërministror për OZHQ-të dhe siguron udhëheqjen për aktivitetin e grupit të punës për OZHQ-të.

III. Raporti Kombëtar Vullnetar

Në kuadër të procesit të zbatimit të OZHQ-ve, Qeveria shqiptare mori angazhimin të raportojë një Raport Vullnetar Kombëtar me temë "Transformimi drejt shoqërive të qëndrueshme" në OZHQ-të në Forumin Politik të Nivelit të Lartë, të zhvilluar në Shtator 2018, në Nju Jork. Ky forum konsiderohet platforma kryesore e Kombeve të Bashkuara mbi zhvillimin e qëndrueshëm, me një rol qendrorë në vazhdimësinë dhe rishikimin e Axhendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel global.

Shqipëria është ndër vendet e para në rajon, që ndërmarrin një hap për përgatitjen dhe prezantimin e një raporti të tillë, i cili synon të lehtësojë shkëmbimin e përvojave, duke përfshirë sukseset, sfidat dhe mësimet e nxjerra, me qëllim të përsheptimit të zbatimit të Axhendës 2030. Ky raport synon të mobilizojë dhe të ndikojë në politikat dhe ndërveprimin ndërmjet institucioneve të qeverive për të forcuar mbështetjen e mëtejshme dhe partneritetet për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Më konkretisht, qëllimi i Raportit Vullnetar Kombëtar është të sigurojë informacion mbi procesin e zbatimit të OZHQ-ve në Shqipëri dhe rezultatet e arritura. Fokusi i raportit thekson përparimin rreth prioriteteve kryesore të qeverisë, të cilat përfshijnë:

- Shërbime publike inovative dhe të përqendruara tek qytetarët;
- Rimëkëmbja dhe konsolidimi financiar i sektorit të energjisë;
- Nxitja e inovacionit dhe konkurrencës, investimet e huaja direkte dhe investimet vendase;
- Menaxhimi i integruar i ujit;
- Menaxhimi i integruar i tokës;
- Reformat strukturore financiare.

Raporti integron progresin e arritur përmes dy proceseve të rëndësishme transformuese, reformën e sektorit të drejtësisë i projektuar për të forcuar sistemin gjyqësor dhe programin e rilindjes urbane që synon transformimin dhe promovimin e karakteristikave të rëndësishme të Shqipërisë, me një fokus të veçantë në përmirësimin e qendrave të zhvillimit në të gjithë vendin. Raporti Kombëtar Vullnetar elaboron përpjekjet dhe politikat që kanë në qendër qytetarin për të mos lënë askënd pas, duke u fokusuar në dy aspekte të rëndësishme për ndërtimin e shoqërive të qëndrueshme: *fuzizimi i grave dhe përfshirja sociale*.

Raporti pranon faktin që arritja e OZHQ në Shqipëri do të kërkonte angazhim të mëtejshëm dhe të konsiderueshëm dhe bashkëpunim të të gjithë aktorëve relevantë në vend. Sfidat kryesore në këtë proces përfshijnë përpjekjet për krijimin e vizionit kombëtar për vitin 2030, veçanërisht në

fushat më të rëndësishme të politikave për Shqipërinë, identifikimin e boshllëqeve të politikave dhe përshpejtimin e veprimeve në fushat prioritare, *prioritizimin e OZHQ-ve në kontekstin lokal* dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të të gjithë aktorëve kryesorë të angazhuar në proces, duke përfshirë institucionet monitoruese dhe raportuese.

IV. Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit në ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Axhenda 2030 është një plan veprimi për njerëzit, planetin dhe mirëqënien e fokusuar në forcimin e paqes universale në liri të plotë, eliminimin e varfërisë në të gjitha format dhe përmasat e saj, luftën kundër pabarazisë dhe padrejtësive dhe ndryshimet klimaterike.

Institucioni i Avokatit të Popullit si një nga aktorët e angazhuar në mbrojtje dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka dhe duhet të luajë një rol specifik në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Axhendës. Kjo, bazuar edhe në Deklaratën e Meridës “*Mbi rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm*”, miratuar në muajin Tetor 2015 në Meksikë, në Konferencën e 12-të të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC-Aktualisht GANNHRI), ku përcaktohet roli dhe veprimet që duhet të ndërmarrin institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut për këtë proces.

Duke qenë një Axhendë gjithëpërfshirëse që vendos prioritete në çështjet që ndikojnë tek njerëzimi në nivel global, me qëllim dhënien fund të varfërisë dhe urisë, sigurimin e qasjes në kujdesin shëndetësor, arsimin gjithëpërfshirës, aksesin në burime si ujë i pijshëm dhe energji elektrike, rritjen ekonomike dhe punësimin, shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, etj, me aplikimin e saj universal dhe rëndësinë për formësimin e prioriteteve të zhvillimit, Axhenda 2030 do të hapë shtigje të reja për integrimin e të drejtave të njeriut në politikat globale dhe kombëtare përgjatë 15 viteve të ardhshme.

Në këtë aspekt, edhe sfidat për punën e Institucionit të Avokati i Popullit do të jenë të vazhdueshme dhe jo të lehta. Deri më sot, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një sërë angazhimesh dhe kontributesh për këtë nisëm mjaft të rëndësishme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Vlen të përmendet bashkëpunimi i vazhdueshme me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Tiranë, pjesëmarrja në trajnime të ndryshme që lidhen me OZHQ-të si dhe dhënia e kontributeve konkrete në hartimin e Raportit të regjuesve të OZHQ 16.1 dhe 16.2.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Tiranë, përgjatë dy viteve të fundit, ka organizuar Konferenca Kombëtare të fokusuar në ndërthurjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të Drejtave të Njeriut, në synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe roli i Institucioneve të të Drejtave të Njeriut në zbatimin e tyre. Avokati i Popullit në mënyrë

të vazhdueshme ka shprehur opinionet mbi ndërhyrjet që i duhen bërë Buxhetit të Shtetit, duke reflektuar në to problemet dhe shqetësimet e qytetarëve, duke theksuar faktin se *“Buxheti i Shtetit është një instrument i pazëvendësueshëm dhe kryesor në realizimin e këtyre objektivave. Ai duhet të jetë shprehje e këtij qëllimi të shtetit shqiptar për t’i realizuar ato edhe në vitet në vijim”*.

Vizioni i ardhshëm i Avokatit të Popullit, sikurse edhe vizioni i çdo aktori të përfshirë për realizimin e kësaj ambicie është që *“askush të mos ngelet pas”* dhe gjithkujt e kudo t’i realizohet dinjiteti njerëzor dhe t’i respektohen plotësisht të drejtat e tij. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë tashmë pjesë e punës të përditshme të institucionit të Avokatit të Popullit për monitorimin, parandalimin e cënimit të të drejtave të njeriut, si edhe promovimin e tyre.

Bazë e rëndësishme në punën e institucionit të Avokatit të Popullit mbetet edhe Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me datë 04.12.2017, ku mes të tjerash anëtarët e Kuvendit angazhohen të nxisin bashkëpunimin me institucione të pavarura të llogaridhënies siç janë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (Avokati i Popullit).

Nisur nga sa më sipër, sfidat për punën e institucionit të Avokati i Popullit do të duhet të jenë, ndër të tjera:

- ✓ Ngritja e mekanizmave për monitorimin dhe zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- ✓ Monitorimi i vazhdueshëm i të drejtave të njeriut me fokus identifikimin e problematikave për grupet në nevojë, duke siguruar në çdo rast respektimin e të drejtave të njeriut nga çdo institucion, bazuar në 17 objektivat për zhvillim të qëndrueshëm;
- ✓ Integrimi në mënyrë të qartë të 17 OZHQ-ve në plane veprimi, raporte dhe dokumente të tjera, bazuar në referenca të qarta ndaj këtyre objektivave, të prodhuara nga institucioni i Avokatit të Popullit. Publikimi i këtyre raporteve do të shërbejë për të nxitur shtetin në zbatimin e kësaj Axhende;
- ✓ Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të mbështetur institucionet e të drejtave të njeriut në zhvillimin e mjeteve, metodologjisë dhe kapaciteteve për të monitoruar zbatimin objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- ✓ Bashkëpunimi i ngushtë me të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e Axhendës 2030.
- ✓ Hartimi i një metodologjie të qartë monitorimi mbi zbatimin e 17 OZHQ-ve. Kjo do të shërbejë si bazë për të monitoruar cilësinë e hartimit, zbatimit dhe raportimit të politikave nga ana e qeverisë. Ndihma e partnerëve ndërkombëtarë në ngritjen e kapaciteteve dhe metodologjisë për monitorimin e zbatimit të objektivave është thelbësore.
- ✓ Mbledhja e të dhënave dhe ngritja e një databaze, me qëllim identifikimin e të gjithë atyre grupeve në nevojë/individëve më të pambrojtur, të lënë në harresë duke ndihmuar në zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për të gjitha grupet.
- ✓ Bashkëpunimi me institucione të tjera që prodhojnë dhe grumbullojnë të dhëna statistikore përfshirë INSTAT, botën akademike dhe organizata të shoqërisë civile.

Nga ana tjetër, mbetet e rëndësishme për Institucionin e Avokatit të Popullit, që në kuadër të zbatimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të:

- ✓ Inkurajojë Qeverinë në përgatitjen dhe zbatimin e Planit të Veprimit, në bashkëpunim me të gjithë aktorët në vend, i cili do të përshkruajë se si Shqipëria synon të arrijë 17 OZHQ-të në kuadër të realizimit konkret të Axhendës 2030.
- ✓ Të nxisë krijimin e një Këshilli Kombëtar koordinimi të nivelit të lartë, i cili të monitorojë përpjekjet e Qeverisë dhe aktorëve të tjerë në përmbushjen e detyrimeve që parashtron Axhenda 2030. Ky këshill duhet të jetë gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, Kuvendit, autoritetet lokale, bota akademike, komuniteti i donatorëve, sektori privat, etj;
- ✓ Të rrisë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e qeverisjes vendore përfshirë Bashkitë, Këshillat Bashkiakë si dhe shoqërinë civile në zbatimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe lidhjen me të drejtat e njeriut;
- ✓ Zbatimin sa më efikas i Axhendës 2030 në nivel qëndror dhe lokal, i cili kërkon një bashkëpunim më të qëndrueshëm ndërsektorial si dhe miratimin e perspektivave multi-dimensionale për zhvillim, të cilat përfshijnë zhvillimin njerëzor dhe një mjedis të qëndrueshëm, si dhe investime për ngritjen e sistemeve, kapaciteteve zbatuese dhe monitoruese dhe të dhënave cilësore për të monitoruar progresin në arritjen e 17 OZHQ-ve/zhvillim për të gjithë.
- ✓ Inkurajojë një rol efektiv të Parlamentit në procesin e zbatimit të Axhendës 2030, si një institucion kyç që garanton miratimin dhe monitorimin e kuadrit ligjor të nevojshëm.

V. Qeverisja lokale dhe zbatimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Që nga Konferenca e OKB-së për Mjedisin dhe Zhvillimin në Rio de Janeiro të Brazilit, në qershor të vitit 1992, qeveritë lokale dhe shoqëria civile kanë fituar një përvojë të pasur se si ta përkthejnë në praktikë Axhendën e Rios në nivel lokal. Më shumë se 6000 iniciativa lokale, 113 vende kanë demonstruar në mënyrën e tyre si të rrisin ndërgjegjësimin, advokojnë dhe zbatojnë praktikisht Agjendën 21 në komunitetet e tyre.

Arritja e OZHQ-ve varet, më shumë se kurrë, nga aftësia e qeverive lokale dhe rajonale për të nxitur një zhvillim të integruar, përfshirës dhe të qëndrueshëm territorial. Siç theksohet në Raportin e Sintetizuar të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së "*shumë nga investimet për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm do të zhvillohen në nivel lokal dhe do të udhëhiqen nga autoritetet lokale.*" Kornizat ligjore dhe politike kombëtare kanë ende një rrugë të gjatë për të shkuar drejt njohjes së saj dhe puna kombëtare dhe ndërkombëtare e advokimit në emër të qeverive lokale dhe rajonale mbetet e domosdoshme.

Autoritetet lokale dhe rajonale luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e Axhendës 2030 dhe objektivave të OZHQ-ve, jo vetëm OZHQ 11, por për të gjitha OZHQ-të. Autoritetet lokale dhe rajonale janë partnerë thelbësorë drejt arritjes së OZHQ-ve. Shumë Njësi të Qeverisjes Vendore

në të gjithë Evropën dhe në mbarë botën po rrisin ndërgjegjësimin për OZHQ-të dhe po kërkojnë mënyra për të integruar OZHQ-të në planet e tyre të politikave: "*Qeveritë lokale dhe rajonale në mbarë botën e konsiderojnë Axhendën 2030 si një mundësi për të shkaktuar një transformim të vërtetë universal*".

Duke marrë parasysh faktin që politikat dhe investimet më themelore janë një përgjegjësi e përbashkët midis niveleve të qeverisë dhe se rreth 65% e 169 synimeve që i përkasin 17 OZHQ-ve nuk do të arrihen pa angazhimin e duhur dhe koordinimin me qeveritë lokale dhe rajonale, është e nevojshme të njihet dhe kuptohet drejt dimensionin territorial i OZHQ-ve.

Ndërkohë që OZHQ-të janë globale, arritjet e tyre do të varen nga aftësia jonë për t'i bërë ato një realitet në bashkitë dhe rajonet tona. Të gjitha OZHQ-të kanë objektiva të lidhura drejtpërdrejtë me përgjegjësitë e qeverive lokale, veçanërisht në rolin e tyre në ofrimin e shërbimeve bazë. Kjo është arsyeja pse Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të jenë në qendër të Axhendës 2030.

Është e rëndësishme jo vetëm që të fokusohet në fushat tematike, por të zbatohet një qasje territoriale në zbatimin e qëllimeve, duke marrë parasysh edhe veçoritë e njësive territoriale, duke siguruar në të njëjtën kohë koherencën politike nëpërmjet monitorimit adekuat të zbatimit të të gjitha OZHQ-ve në terren.

Autoritetet lokale, si dhe shoqëria civile lokale, janë më afër qytetarëve dhe prandaj janë në gjendje të zhvillojnë modele të shërbimeve, në përputhje me nevojat në zhvillimin e komuniteteve. Instrumentet financiare dhe politike të qeverive duhet të përdoren për të nxitur risi dhe për të rritur investimet në shërbimet transformuese të bazuara në komunitet, të cilat mbështesin arritjen e OZHQ-të deri në vitin 2030.

Për arsyet sa më sipër, vlerësohet e nevojshme përcaktimi i një udhërrëfyese (roadmap) që të ofrojë mjetet dhe instrumentet përkatëse në praktikë, për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen për rolin aktivë të aktorëve lokalë në lokalizimin e OZHQ-ve, si dhe në mbështetjen e tyre në marrjen e vendimeve që kontribuojnë në arritjen e objektivave të zhvillimit të qendrueshëm.

Ky udhërrëfyese për lokalizimin e OZHQ-ve, i bazuar dhe në roadmap-in e hartuar nga Taskforca Globale e Qeverive Lokale dhe Rajonale, UNDP dhe Habitat-i i OKB-së për të mbështetur qytetet dhe rajonet për të zbatuar axhendën 2030, duhet të mbështetet në elementët e mëposhtme:

V.1 Rritja e ndërgjegjësimit

Strukturat qeveritare, organizatat e shoqërisë civile, sektori privat, bota akademike dhe qytetarët duhet të përfshihen të gjithë në zbatimin dhe monitorimin e OZHQ-ve. Fushatat ndërgjegjësuere duhet të zhvillohen në nivel kombëtar dhe lokal, duke mobilizuar dhe ndërtuar partneritete me aktorë të ndryshëm lokalë, duke sjellë së bashku të gjithë sektorët e shoqërisë, duke rritur

pjesëmarrjen e tyre dhe duke siguruar që diversiteti të përqafohet. Si shkalla më e afërt e qeverisjes tek njerëzit, njësitë e qeverisjes vendore duhet të rrisin ndërgjegjësimin për OZHQ-të dhe rëndësinë e tyre për komunitetet lokale.

Qeverisja vendore duhet të kapërcejë hendekun ndërmjet qeverisë qendrore dhe komuniteteve lokale si dhe duhet të luajë një rol të fuqishëm në nxitjen e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), botës akademike dhe organizatave të tjera të bazuara në komunitet. Drejtuesit e zgjedhur në nivel lokal, në veçanti, kanë një mandat demokratik për të udhëhequr zhvillimin lokal dhe janë përgjegjës para qytetarëve të tyre nëse nuk arrijnë ta bëjnë këtë.

Përgjegjësia e tillë demokratike është një mjet i fuqishëm për të çuar në realizimin e OZHQ-ve në nivel lokal. Aktivitetet e ndërgjegjësimit duhet të synojnë rritjen e angazhimit të qytetarëve dhe komuniteteve lokale për të promovuar ndjenjën e tyre të pronësisë të Agjendës 2030 dhe pjesëmarrjen e tyre në arritjen e OZHQ-ve në nivel lokal. Por rritja e ndërgjegjësimit nuk ka të bëjë vetëm me informimin e qytetarëve për ekzistencën e OZHQ-ve. Ajo ka të bëjë dhe me fuqizimin e tyre për të marrë pjesë në arritjen e OZHQ-ve në jetën e tyre të përditshme. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të mbështeten për të njohur Axhendën 2030 si një kornizë për veprim dhe për të krijuar mekanizma që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe llogaridhënien institucionale.

Për gjitha sa më sipër, mbetet e nevojshme:

- ✓ Forcimi i kapaciteteve të shoqatave të autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile për të vepruar në mënyrë të qëndrueshme si nxitës për zhvillim;
- ✓ Informimi, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e qytetarëve në çështjet lokale dhe edukimin zhvillimor;
- ✓ Zhvillimi dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile.

V.2. Advokimi/ përfshirë perspektivën në nivel lokal të strategjive kombëtare që lidhen me OZHQ

Shoqatat kombëtare të njësive të qeverisjes vendore kanë një detyrë të rëndësishme në lehtësimin e pjesëmarrjes së njësive vendore në zhvillimin e këtyre strategjive kombëtare në mënyrë që ato të reflektojnë dhe t'i përgjigjen rrethanave lokale, nevojave dhe prioriteteve. Promovimi i pronësisë lokale të strategjive kombëtare është jetike. Nëse njësitë e qeverisjes vendore kanë ndjenjën e pronësisë së OZHQ-ve dhe një rol në përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të tyre, përfshirja e tyre në zbatim do të jetë më e madhe.

Një mjedis i përshtatshëm për lokalizimin e OZHQ-ve përfshin:

- ✓ Një kornizë ligjore dhe politike që garanton demokracinë dhe respektin për të drejtat e njeriut;

- ✓ Një organ legjislativ dhe një nivel decentralizimi që ju njeh njësive të qeverisjes vendore një nivel autonomie me kompetenca ligjore, autonomi financiare, role dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë dhe aftësi për të mbrojtur zërin e qytetarëve para autoriteteve qendrore;
- ✓ Mekanizma qeverisjeje në shumë nivele dhe partneritete shumëpalëshe;
- ✓ Njohja e nevojës për të bërë transferime financiare nga qeveria qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore në mënyrë që të korrigjohen pabarazitë midis detyrave të ngarkuara dhe burimeve të kufizuara që disponojnë. Njësitë e qeverisjes vendore duhet gjithashtu të kenë kompetencat ligjore për vendosjen e taksave të tyre, me qëllim që të zbatojnë në mënyrë efektive rrugët e tyre të përcaktuara të zhvillimit në nivel lokal dhe të sigurojnë llogaridhënien ndaj komuniteteve lokale;
- ✓ Ngritja e kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore në lidhje me OZHQ-të, duke i fuqizuar ata që të maksimizojnë kontributet e tyre, madje edhe përballë kompetencave të kufizuara;
- ✓ Masa për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së njësive të qeverisjes vendore, si dhe për t'i mbështetur ato në përmirësimin e vazhdueshëm.

V.3 Zbatimi/ OZHQ-të në nivel lokal

Çdo nivel qeverisjeje duhet të ketë kapacitetin për të vendosur prioritetet e tyre në përputhje me fushat ligjore të përgjegjësisë dhe për t'i ndjekur ato përmes planeve lokale dhe politikave sektoriale. Për të përcaktuar prioritetet lokale, duhet të rishikohen programet ekzistuese lokale me qëllim identifikimin e nevojave, prioritetëve, boshllëqeve dhe lidhjeve ndërsektoriale në hapësirat lokale, marrëdhëniet e tyre me OZHQ-të dhe prioritetet kombëtare. Është thelbësore që njësitë e qeverisjes vendore të sigurojnë që prioritetet e tyre në kuadër të OZHQ-ve janë relevante dhe në pronësi lokale dhe që përfshijnë interesat e niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe aktorëve lokalë, duke përfshirë pakicat dhe grupet në nevojë.

Në një kontekst të burimeve të pakta, buxhetet vendore duhet të përafrohen në mënyrë efektive me prioritetet e identifikuar dhe të vendosura në planet zhvillimore lokale ose rajonale. Kjo nënkupton shpërndarje apo rishpërndarje të burimeve të disponueshme për të realizuar prioritetet e përafroara me OZHQ-të. Është gjithashtu e rëndësishme për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e menaxhimit brenda njësive të qeverisjes vendore për të siguruar një përdorim më efektiv të burimeve në dispozicion. Kjo përfshin përmirësimin e skemave organizative, menaxhimin e taksave, buxhetimin (duke përfshirë buxhetimin me pjesëmarrje), prokurimin publik, transparencën, luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe sigurimin e aftësive dhe kapaciteteve të reja të stafit të njësive të qeverisjes vendore përmes iniciativave të forcimit të kapaciteteve në fusha të ndryshme si menaxhimi i borxhit publik dhe qasja në kredi private.

Për rrjedhojë, mbetet e nevojshme ndërmarrja e hapave të mëtejshëm:

- Kryerja e një vlerësimi të nevojave për të përcaktuar prioritetet dhe lokalizimin e OZHQ-ve;
- Përafrimi i planeve lokale me OZHQ-të;

- Mobilizimi i burimeve locale;
- Ndërtimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive dhe të përgjegjshme;
- Promovimi i pronësisë dhe bashkëpërgjegjësisë për zbatimin e projekteve strategjike;
- Pjesëmarrja në projektet e zhvillimit dhe të *peer-to-peer learning*;

V.4. Monitorimi

Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë mekanizma adekuate për të mbledhur informacione dhe të dhëna në nivel vendor dhe të dhënat lokale shpesh nuk janë në përputhje me sistemet kombëtare të mbledhjes së të dhënave. Megjithatë, ekzistojnë shembuj të qyteteve dhe rajoneve që kanë krijuar institucionet e tyre statistikore për të plotësuar shërbimet e planifikimit. Forcimi i këtyre institucioneve do të jetë thelbësor për të monitoruar dhe vlerësuar arritjet e OZHQ-ve në nivel vendor.

OKB ka ndërmarrë një përpjekje të veçantë për ta bërë monitorimin në nivel lokal dhe rajonal një prioritet në rastin e OZHQ-ve. Krijimi i sistemeve të mbledhjes së të dhënave në nivel lokal dhe rajonal është thelbësor për të shpërndarë informacionin "sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike dhe karakteristikave të tjera relevante në kontekstin kombëtar" dhe për të monitoruar proceset dhe rezultatet përmes indikatorëve.

Marrëveshjet e bashkëpunimit duhet të nënshkruhen nga nivele të ndryshme të qeverisjes, për të siguruar shkëmbimin e informacionit. Duhet promovuar një '*revolucion i të dhënave*' për të kontribuar në monitorimin dhe arritjen e OZHQ-ve. Universitetet, qendrat kërkimore, madje edhe OJQ-të e sektori privat, mund të ndihmojnë në mbledhjen, monitorimin dhe analizimin e të dhënave.

Zbatimi i OZHQ-ve kërkon krijimin e një hapësire për dialog ose platformë shkëmbimi midis politikanëve, administratës publike, palëve të interesuara dhe shoqërisë civile për të diskutuar hapur dhe reflektuar mbi nevojat lokal/ urbane dhe hapat e nevojshëm të zbatimit si dhe ndarjen dhe shkëmbimin e shembujve e praktikave të mira nga të gjitha nivelet e zbatimit të OZHQ-ve në nivel vendor.

Është e rëndësishme rritja e kapaciteteve të aktorëve lokalë në mënyrë që ata të bëhen më të motivuar, të angazhuar dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në dialogje dhe platforma për zbatimin e OZHQ-ve si dhe të kontribuojnë në nivele sa më të larta në realizimin e tyre. Gjithashtu, po aq e rëndësishme është lidhja e OZHQ-ve me aktivitetet lokale dhe urbane që tashmë po ndodhin dhe që janë të njohura (p.sh. efikasitetin e energjisë, emëtimet e CO₂, ndryshimet klimatike, zvogëlimin e varfërisë etj).

Edukimi në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe OZHQ-të konsiderohet pjesë e rëndësishme e këtij procesi. Duhet filluar sa më shpejt që të jetë e mundur në këtë drejtim (p.sh. në nivelet e

shkollave fillore dhe të mesme me programe të dedikuara OZHQ-ve), ku dhe bizneset mund të jenë gjithashtu një burim i vlefshëm në edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm.

Pjesë e këtij procesi duhet të jetë dhe Informimi i politikëbërësve lokalë për përfitimet dhe mundësitë që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe OZHQ-të (p.sh. cilësinë e jetës, mirëqenien, mjedisin, ekonominë etj, duke e lidhur me axhendën e tyre aktuale politike).

VI. Situata aktuale për arritjen e OZHQ-ve në nivel vendor

Axhenda 2030 mund të sjellë ndryshimin nëse përshtatet me realitetin dhe sfidat që ka çdo njësi e qeverisjes vendore në Shqipëri. Procesi i integritit në Bashkimin Evropian mbetet shtylla kryesore e zhvillimit që krijon sinergji me proceset e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Qeverisja lokale është faktor kryesor në kthimin e Agjendës 2030 nga një vizion global në një realitet lokal. Kur flasim për OZHQ-të, kemi parasysh objektiva të tilla që lidhen me eliminimin e varfërisë, arritjen e një arsimit cilësor, reduktimin e pabarazisë, nxitjen e barazisë gjinore, kujdesin shëndetësor, zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit, forcimin e procesit të mirëqeverisjes etj, për zbatueshmërinë e të cilave qeverisja vendore ka rolin e saj të pazëvendësueshëm.

Reforma territoriale dhe administrative (2015) uli numrin e njësive të qeverisjes vendore në vend nga 384 në 61, duke mundësuar krijimin e njësive vendore më të mëdha e me kapacitet më të madhë institucional. Përveç menaxhimit më efektiv të ofrimit të shërbimeve lokale, këto njësi të qeverisjes vendore duhet të jenë më efektive për të hartuar dhe zbatuar programet e zhvillimit rajonal. Kapaciteti më i fortë i monitorimit dhe vlerësimit që mund të pritët nga këto njësi mund të ndihmojë gjithashtu me "lokalizimin e OZHQ-ve", nëpërmjet përdorimit të zgjeruar të synimeve dhe treguesve të OZHQ-ve në planifikimin e zhvillimit lokal.

Reforma territoriale paraqiti ndryshime të mëdha në peizazhet e qeverisjes (kombëtare dhe lokale) në Shqipëri, duke përfshirë sigurimin e kompetencave më të gjera për zhvillimin ekonomik lokal, ofrimin e shërbimeve, planifikimin territorial, menaxhimin e mjedisit, menaxhimin e tokës, transportin, mirëqenien, kujdesin social etj. Në të njëjtën kohë, kjo ka rritur pritshmëritë e qytetarëve, ndërsa njësitë e qeverisjes vendore po përpiqen të përqafojnë dhe të përshtaten me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre të reja.

Në kuadër të zbatimit të projektit *“Monitorimi dhe promovimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale për grupet vulnerabël në nivel kombëtar dhe lokal”*, u realizua një vlerësim në bashkinë e Kukësit, Librazhdit dhe Elbasanit në lidhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, masat e marra, mjetet e përdorura për arritjen e tyre dhe indikatorët për matjen e tyre. Vlerësimi u fokusua në drejtimit e mëposhtme:

- Vlerësimin e njohurive të bashkive për Axhendën 2030;
- Vlerësimin e përfshirjes të OZHQ-ve në planet e tyre strategjike dhe të veprimit;
- Vlerësimin e masave të marra dhe instrumentet e përdorura për arritjen e tyre dhe indikatorët për matjen e tyre.

Ky vlerësim u mbështet në intervistat e zhvilluara me përfaqësues të këtyre njësive vendore, bazuar në një pyetësor të përgatitur paraprakisht me rreth 15 pyetje që kishin të bënin kryesisht me informimin në lidhje me OZHQ-të; nivelin e bashkëpunimit me pushtetin qendror në kuadër të këtyre objektivave; veprimet konkrete që janë marrë për zbatimin e OZHQ-ve; krijimin e ndonjë mekanizmi institucional për monitorimin e arritjeve të OZHQ-ve; niveli i trajnimeve apo aktiviteteve ndërgjegjësuere të realizuara për këtë proces; ndikimin që kanë këto objektiva në përmirësimin e cilësisë të shërbimeve për qytetarët; përfshirjen e tyre në strategjitë dhe planet lokale të veprimit; sfidat dhe problematikat e hasura etj.

Nga përgjigjet e dhëna nga përfaqësues të këtyre njësive vendore, konstatohet në përgjithësi:

- ✓ një mungesë informacioni në lidhje me atë se çfarë realisht përfaqësojnë këto objektiva;
- ✓ mungesë informacioni në lidhje me përfitimet dhe mundësitë që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm dhe OZHQ-të;
- ✓ mungesë të mekanizmave monitorues për zbatimin e OZHQ-ve dhe mekanizma adekuate për të mbledhur informacione dhe të dhëna;
- ✓ nevojë për trajnime dhe sensibilizim më të madh për të kuptuar rëndësinë e këtyre objektivave;
- ✓ rritjen e mbështetjes nga pushteti qendror me qëllim “lokalizimin” e OZHQ-ve;
- ✓ përfshirjen e OZHQ-ve në strategjitë lokale dhe planet zhvillimore të veprimit;
- ✓ forcim të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe mbështetje financiare për arritjen e OZHQ-ve;
- ✓ prioritarizimin e OZHQ-ve në kontekst lokal si dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të të gjithë aktorëve kryesorë, përfshirë dhe strukturat monitoruese dhe raportuese;
- ✓ nevojën e forcimit të bashkëpunimit të njësive të pushtetit vendor me shoqërinë civile lokale, median, biznesin etj;
- ✓ menaxhim më të mirë nga njësitë e qeverisjes vendore të përgjegjësitë të reja në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social;
- ✓ nevojën e krijimit të një platforme diskutimi me përfshirjen e aktorëve të interesuar (pushtet qendror/lokal, shoqëri civile etj) për të diskutuar hapur dhe reflektuar mbi nevojat lokale / urbane dhe hapat e nevojshëm të zbatimit si dhe ndarjen dhe shkëmbimin e shembujve e praktikave të mira nga të gjitha nivelet e zbatimit të OZHQ-ve në nivel vendor;
- ✓ rritjen e aftësive të njësive të qeverisjes vendore për të nxitur një zhvillim të integruar, përfshirës dhe të qëndrueshëm territorial.

Si institucione të vijës së parë për zhvillimin lokal, njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri duhet të kenë personel të mjaftueshëm, të strukturuar dhe të financuar. Në këtë drejtim, mbështetja për llogaridhënien e qeverisjes lokale në fushat e mëposhtme konsiderohet veçanërisht e rëndësishme:

1. *Menaxhimi i financave publike lokale.* Duke siguruar që njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për cilësinë e shërbimeve të ofruara për komunitetet lokale, kjo do të

kërkonte përmirësime të mëtejshme në menaxhimin financiar publik lokal, transferime fiskale më të parashikueshme nga qeveria qendrore dhe përdorimi më i mirë i instrumenteve buxhetore gjithëpërfshirëse, bazuar në qasjen gjinore dhe performancën.

2. *Përmirësimi i strukturave të qeverisjes vendore* për të reflektuar më mirë funksionet e tyre të dallueshme, objektivat e performancës dhe burimet njerëzore.
3. *Përshatja e mëtejshme e shërbimeve me një ndalesë* (dhe mekanizme të tjerë të ofrimit të shërbimeve lokale) për t'iu përgjigjur nevojave të grupeve në nevojë.
4. *Rishikimi i roleve të agjencive rajonale të zhvillimit*, veçanërisht në sigurimin e funksioneve teknike, planifikimit dhe koordinimit për të mbështetur administrimin më efektiv territorial.

Në koordinim me këto hapa dhe si një përafrim me avancimin e axhendës së reformave qeverisëse, në nivel horizontal dhe vertikal, një mbështetje në rritje mund t'i kushtohet "lokalizimit të OZHQ-ve". Kjo mund të fillojë me një hartë më të detajuar të programeve të mbështetjes të qeverisjes lokale, si një numër ndërhyrjesh zhvilluese, për të mbështetur njësitë e reja të qeverisjes vendore.

Mbrojtja sociale për grupet në nevojë në Shqipëri është një prioritet i një rëndësie kombëtare dhe që kontribuon në arritjen e objektivit 10, "Reduktimi i pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve", veçanërisht përmes targetit 10.4 "Miratimi i politikave, veçanërisht i politikave të mbrojtjes sociale fiskale, dhe pagave dhe arritjes progresive të një barazie më të madhe". Shpenzimet për mbrojtjen sociale në buxhetin e shtetit ishin në nivelin 9.1% në 2017, nga 8.9% në 2016. Shpenzimet për mbrojtjen sociale përbëhen nga dy skema kryesore:

-*Skema e ndihmës ekonomike*. Për shkak të ndihmës së kufizuar ekonomike që ofrohet, kjo skemë ka një impakt të kufizuar në reduktimin e varfërisë dhe nuk merr në konsideratë të gjitha dimensionet e shumta dhe ndërthurëse të varfërisë (edukimi, kujdesi shëndetësor, kushtet e banimit etj).

- *Pagesa për paaftësi* për njerëz me paaftësi mendore dhe fizike, përfshirë të verbërit, personat paraplegjik dhe tetraplegjik. Familjet që kanë një anëtar me paaftësi marrin një pagesë të mbrojtjes sociale pavarësisht nga situata ekonomike e anëtarëve të familjes.

Reforma e mbrojtjes sociale në Shqipëri është e përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016-2020 dhe në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe Dokumentin e Politikave mbi Përfshirjen Sociale 2015-2020. Reforma synon të përmirësojë targetimin e familjeve dhe personave që marrin asistencë si dhe përmes përafrimit të zbatimit të tij me reforma të tjera që po zbatohen në vend e që lidhen me të.

Fondet sociale tashmë menaxhohen nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat do të ofrohen nga kontributet e pushtetit qendror, bashkitë dhe nga donatorë dhe partnerë të tjerë zhvillues. Si pjesë

e reformës së lart-përmendur, ndërtimi apo forcimi i kapaciteteve të njësive vendore për të menaxhuar përgjegjësitë e reja në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social (duke filluar nga viti 2016), do të marrë kohë për të plotësuar boshllëqet e shumta të kapaciteteve që ekzistojnë në këtë drejtim. Këto përgjegjësi dhe këto shërbime të ofruara lidhen ngushtë me arritjet e OZHQ-ve.

Objektivat globale synojnë zbutjen e varfërisë, pabarazisë dhe ndryshimeve klimatike. Por kjo mund të arrihet vetëm nëse qytetarët ngrenë zërin dhe të kërkojnë tek drejtuesit e institucioneve të mbajnë premtimet e dhëna. Krijimin e një platforme për shkëmbimin e ideve, krijimin e partneriteteve, angazhimin e komuniteteve, ndërtimin e mbështetjes publike dhe nxitjen e veprimeve për arritjen e OZHQ-ve në nivel vendor, konsiderohet prioritare për të qenë të suksesshëm në këtë proces. Në këtë platformë duhet të përfshihen përfaqësues të pushtetit vendor, organizata të shoqërisë civile, media, bota akademike, biznesi, të rinjtë, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri etj.

Rritja e ndërgjegjësimit për arritjet e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm është një instrument për të garantuar suksesin në këtë proces. Përfshirja e të gjithë aktorëve (përfshirë dhe të rinjtë) përmes fushatave ndërgjegjësuese, zhvillimit të ditëve të hapura apo javës së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, do të ndihmonte në njohjen më të mirë të këtyre objektivave si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Gjithashtu, është e rëndësishme zhvillimi i proceseve dhe mekanizmave për të forcuar përfshirjen parlamentare, qasjen në informacion, llogaridhënien dhe transparencën për të inkurajuar përfshirjen më të madhe të shoqërisë civile, të universiteteve, si edhe angazhimin e publikut, veçanërisht nga grupet në nevojë dhe të mënjanuara, në hartimin ose përmirësimin e legjislacionit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij dhe politikave kombëtare që synojnë përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në këtë proces, pa dyshim që rol të rëndësishëm mbart edhe pushteti legjislativ. Duke pranuar rëndësinë e tri dimensioneve të zhvillimit të qëndrueshëm, ekonomik, social dhe mjedisor, si edhe nevojën për t'i trajtuar ato në mënyrë gjithëpërfshirëse, në lidhje të ngushtë me masat për të përmirësuar strukturën institucionale dhe kapacitetet në nivel kombëtar, Kuvendi mund të orientojë Qeverinë (Komitetin Ndërmintor për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për të përmbushur Axhendën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si në nivel kombëtar, ashtu edhe vendor.

Por jo vetëm, roli i Kuvendit mund të jetë shumë efektiv në sigurimin e zhvillimit dhe përdorimit të mjeteve për t'u mundësuar parlamentarëve të kryejnë një mbikëqyrje më efektive të ligjeve, të buxheteve, programeve dhe politikave të propozuara për të vlerësuar kontributin e tyre në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për rrjedhojë, është e domosdoshme që ky organ të punojë së bashku me Qeverinë dhe të gjithë partnerët dhe grupet e interesit, për të rishikuar kuadrin ligjor ekzistues dhe për të identifikuar mundësitë për të çuar më tej zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht miratimin ose ndryshimin e ligjeve për të promovuar barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit. Mbetet shumë e rëndësishme, gjithashtu, që Kuvendi të ofrojë mbështetje për institucionet qeverisëse në nivel vendor për të zbatuar dhe monitoruar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke pranuar se ato janë më afër me qytetarët dhe shpesh kanë përgjegjësi për çështje të rëndësishme në arritjen e OZHQ-ve.

Në përfundim, duhet të theksohet se arritja e OZHQ-ve në Shqipëri do të kërkonte angazhim të mëtejshëm dhe të konsiderueshëm dhe bashkëpunim të të gjithë aktorëve relevantë në vend. Sfidat kryesore në këtë proces përfshijnë përpjekjet për krijimin e vizionit kombëtar për vitin 2030, veçanërisht në fushat më të rëndësishme të politikave për Shqipërinë, identifikimin e boshllëqeve të politikave dhe përshpejtimin e veprimeve në fushat prioritare, prioritizimin e OZHQ-ve në kontekstin lokal dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të të gjithë aktorëve kryesorë të angazhuar në proces, duke përfshirë institucionet monitoruese dhe raportuese.